

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"PRORENT AL" SHPK

Mbështetur në ligjin nr.9901 datë 20.04.2008 "Për shoqëritë tregtare", në ligjin nr.9723 datë 03.05.2077 "Për QKB", **sot më datë 22 Dhjetor 2022** me vullnetin e lirë dhe të plotë vendosëm të krijojmë dhe miratojmë statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar

"PRORENT AL" **Sh.p.k** me këtë përbajtje

Neni 1-Forma dhe Emërtimi

Shoqëria "PRORENT AL" **Sh.p.k** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, subjekt juridik shqiptar ,veprimtaria e së cilës do të rregullohet me anë të këtij Statuti dhe nga legjislacioni shqiptar në fuqi. Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë rregjistruar në QKB në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Ky statut është përpiluar në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe ka karakter të detyrueshëm pér nënshkruesit e tij. Çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në të , plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 2-Themeluesit

Themeluesi I Shoqërisë "PRORENT AL" **Sh.p.k** është:

-**Z. Marvi Shehu**, shtetas shqiptar , lindur më 24.07.1991 , në Tiranë, Shqipëri dhe banues në Tiranë ,i identifikuar me nr. Pasaporte BC5392422 dhe me nr. Personal J10724077D, madhor dhe me zotësi të plotë juridike pér të vepruar;

-**Z. Elio Berberi** shtetas shqiptar , lindur më 30.01.1991 , në Tiranë, Shqipëri dhe banues në Tiranë ,i identifikuar me letërmjoftim nr.034256229 dhe me nr. Personal J10130049K, madhor dhe me zotësi të plotë juridike pér të vepruar;

Neni 3 -Selia

Shoqëria "PRORENT AL" **Sh.p.k** e ka selinë në : Rruga Kavajës, Kompleksi Delijorgji , Pallati nr.3 , Kati I parë , nr. Pasurie 6/335+2-N6, Zonë Kadastrale 8220, 1001 , Tiranë.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj , të hapë zyra përfaqësie, degë , të krijojë filiale, vetëm me vendim të Asamblesë së përgjithshme të ortakëve.

Neni 4-Objekti

Shoqëria do ketë si objekt të veprimtarisë së saj: Qiradhënien e automjeteve në përputhje me rregullat në fuqi.

Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj me vendim të Asamblesë së përgjithshme të ortakëve.

Neni 5-Kohëzgjatja

Shoqëria "PRORENT AL" **Sh.p.k** kryen veprimtarinë e saj për një periudhë kohore të pacaktuar derisa të vendoset ndryshe nga Asambleja e përgjithshme e ortakëve.

Neni 6-Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë "PRORENT AL" **Sh.p.k** është 100 000 (njëqind mijë) lekë. Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tij të mëposhtëm:

- Ortaku themelues Z. Marvi Shehu : Zotëruar i 1 kuote me vlerë të përgjithshme 67000 (gjashtëdhjetë e shtatë mijë) lekë që përbën 67% të kapitalit themeltar,;
- Ortaku themelues Z. Elio Berberi: Zotëruar i 1 kuote me vlerë të përgjithshme 33000 (tridhjetë e tre mijë) lekë që përbën 33% të kapitalit themeltar;

Në rast zmadhimi apo zvogëlimi të kapitalit themeltar të Shoqërisë, ortakët do të kenë të drejtën e nënshkrimit të zmadhimit apo zvogëlimit të kapitalit në përpjestim të drejtë me pjesëmarrjen që zotëron secili në kapitalin e Shoqërisë. Ortaku përgjigjet për humbjen e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit themeltar të shoqërisë.

Neni 7-Transferimi I kapitalit

- Kuotat e kapitalit të shoqërisë “PRORENT AL Shpk ” e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nepërmjet: a) kontributit në kapitalin e shoqërisë b) shitblerjes; c) trashëgimise; d) dhurimit; e) çdo mënyrë tjetër e parashikuar me ligi.
Në rast transferimi të kuotës së kapitalit themeltar tek një subjekt i tretë, ortaku është i detyruar të lajmërojë ortakët e tjerë të paktën 30 (tridhjetë) ditë para duke i venë në djeni mbi kushtet e transferimit. Ortakët e tjerë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i sipërpërmendur mund të ushtrojnë të drejtën e parablerjes me të njëjtat kushte.
Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, sa kohë nuk parashikohet ndryshe në statut. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8- Organi vendimarrës. Asambleja e përgjithshme e ortakëve.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj.

Asambleja e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme a) percaktimin e politikave tregtare te shoqërisë; b) emërimin, shkarkimin dhe përcaktimin e shpërblimeve të administratorëve; c) emerimin e shkarkimin, dhe percaktimin e shpërblimeve te likujduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë, e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; f) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit; g) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre; h) perfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimentet e tjera ndaj administratorëve; i) riorganizimin e shkrirjen e shoqërisë; l) miratimin e rregullave të të Asamblessë; m) çështje të tjera te miratura nga ligii apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e përgjithshme, në bazë te një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në Asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së përgjithshme, e cila mund të perfshijë edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.

Neni 9 — Organi vendimarrës. Asambleja e përgjithshme e ortakëve.

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet te përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo me vonë se 7 dite përrpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të ketij nenit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marre vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10 – Kuorumi.

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.



Në rastin kur Asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, votojnë personalisht, me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse Asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11 – Marrja e vendimeve.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve vendos me tre të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si: a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë; b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve; c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; d) përcaktimin e shpërblimeve; e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë; f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;



Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12 – Përjashtimi nga e drejta e votës.

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
a) vlerësimin e veprimtarisë së tij; b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13 – Administrimi

Asambleja e përgjithshme emeron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emëritit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Cdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë i shoqërisë deri në emërimin e tij nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme së ortakëve:

Z. Marvi Shehu, shtetas shqiptar , lindur më 24.07.1991 , në Tiranë, Shqipëri dhe banues në Tiranë , i identifikuar me nr. Pasaporte BC5392422 dhe me nr. Personal J10724077D, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;



Neni 14 – Kompetencat e administratoreve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të: a) kryejnë të gjitha veprimet e administritimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme; b) përfaqësojnë shoqérinë tregtare; c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë; d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim; e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë; f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënrat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit; g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e aktiviteteve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare; h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur: a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim; c) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjeter aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 (pesë) për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara; d) shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 (pesë) për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15 - Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, administratori detyrohet: a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesid; b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita; c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim; d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë; e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes. si dhe t'i kalojë cdo fitim personal që ai apo personat e lidhur me të kanë realizuar nga

këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, kryen veprimet e mëposhtme: a) u kthen ortakëve kontributet; b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë; c) u shpérndan aktivet shoqërisë; d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet; e) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpérblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 16 - Viti Financiar dhe dispozita të përkohshme mbi ndarjen e fitimeve të shoqërisë.

Viti finanziar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përashtimisht, viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit të shoqërise në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbylltet më 31 Dhjetor.

Neni 17 - Prishja dhe likuidimi i shoqërisë.

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë; a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj; b) me vendim të Asamblese së Ortakëve; c) me hapjen e



procedurave të falimentimit; c) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”; d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqerise, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar ne çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtimin shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur ështënisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Neni 18 - RiorGANIZMI I SHOQERIESË BASHKIMI-NDARJA

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

Neni 20 - Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.


Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, e Kodit Civil dhe të çfarëdo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 21 – Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAKËT
E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"PRORENT AL"

MARVI SHEHU


Marvi Shehu
Orta

ELIO BERBERI


Elio Berber
Orta